



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 11/2006, datë 09.10.2006

Ndryshim i Udhëzimit Administrativ

Nr. 2005/5

NË ZBATIM

TË LIGJIT Nr. 2004/48

“MBI
ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT”

Në përputhje me nenin 60 të Ligjit Nr. 2004/48 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat”, Ministria e Ekonomisë dhe Financave nxjerr Udhëzimin Administrativ ndryshues për zbatimin e nenit 28 .

Neni 1

Qëllimi i këtij ndryshim neni është që duke u nisur nga parimet e përgjithshme të drejtësisë, tatimpaguesve t’u krijohet pozitë më e favorshme karshi dispozitave të reja ligjore që kanë të bëjnë me çështjen e pagesës së interesit për rimbursimet e vonuara për ato kërkesa që janë parashtruar në ATK dhe të cilat edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit kanë qenë të pazgjidhura si dhe me çështjen e aplikimit të dispozitave të reja që kanë të bëjnë me shkeljet dhe ndëshkimet.

Neni 2

Sipas nenit 62 të Ligjit , Ligji hyn në fuqi me 1 maj 2005 dhe aplikohet për ngjarjet siç kanë ndodhur si në vijim:

- **Interesi** për pagesë në shkallën prej 0.15 % në baza mujore mbi rimbursimet e vonuara fillon të aplikohet prej datës 01.05.2005 (kur Ligji ka hyrë në fuqi), pavarësisht kohës kur tatimpaguesit kanë bërë kërkesë në Administratën Tatimore për rimbursim, me kusht që kërkesat e tilla nuk janë zgjidhur para kësaj date. P.sh. , nëse kërkesa është paraqitur para hyrjes në fuqi të Ligjit, p.sh. me datë 15.04.2005, dhe një kërkesë e tillë nuk është shqyrtuar nga ana e autoriteteve të ATK-së, brenda 60 ditësh ashtu siç obligohen me dispozitat ligjore, por është shqyrtuar dhe është vendosur në favor të saj me datë 20.07.2005, atëherë : për periudhën prej 15.06.2005 (data e fundit kur është dashur të vendoset lidhur me kërkesën) e deri me datë 20.07.2005 (kur është aprovuar faktikisht kërkesa), do të llogaritet interesi në shkallën prej 0.15 % , shumë të cilën autoritetet tatimore do të duhet t’ia paguajnë tatimpaguesit së bashku me shumën e rimbursimit.

- **Uljet e ndëshkimeve** për shkak të paraqitjes vullnetare ose përmbushjes përmes marrëveshjes me këste për të paguar borxhet tatimore do të aplikohen vetëm për paraqitjen vullnetare të bërë dhe marrëveshjet me këste, të bëra me ose pas 01.05.2005.

- **Dispozitat** e reja që kanë të bëjnë me shkeljet dhe ndëshkimet, do të aplikohen në lidhje me çfarëdo shkelje të zbuluar me ose pas datës 1 maj 2005, edhe në qoftëse periudha tatimore me të cilën ndërlidhet shkelja është para kësaj date. I vetmi përjashtim lidhur me këtë është ndalja e tatimit në burim për paga nga ana e punëdhënësit, ku paragrafi 11.2 i Rregullores së mëhershme të UNMIK-ut Nr. 2002/4 mbi Tatimin në të Ardhurat Personale në Kosovë, aplikohet për periudhat tatimore 2004 dhe më herët. Dispozitat mbi interesin nga paragrafi 11.3 dhe 11.4 të asaj Rregulloreje janë gjithashtu të aplikueshme për ato periudha të mëhershme.

Neni 3

Me këtë Udhëzim Administrativ shfuqizohet neni 28 i Udhëzimit të mëparshëm Administrativ Nr. 05/2005.

Neni 4

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe vlen për periudhën prej hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 2004/48 e tutje.

Me datë

09/10/06

Ministri i Ekonomisë dhe Financave
Z. Haki Shatri

